



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 10 / 3 prot.

Tiranë më 9.5.2018

VENDIM

Nr. 20, datë 9.5.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 10 Prot., datë 04.01.2018, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencisë së Trajtimit të Pronave”, (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Me kërkesën e datës 14.12.2017 ankuesi ka kërkuar informacion/dokumente zyrtare, konkretisht: *Kopje të Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 155 datë 04.07.1995.*

Me shkresën nr. 6408/1 prot. datë 18.12.2017 Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke argumentuar se ky i fundit nuk legjitimohet në kërkimin e tij.

Autoriteti Publik ka referuar nenin 64 të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, sipas të cilit “*Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve të pronës, përfaqësuesve të tyre ligjore dhe institucioneve shtetëror, që kanë kompetenca vendimmarrëse të njohura me ligj për trashëgiminë e pronave*”.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njëh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv si dhe në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin shprehimisht thuhet se “...me marrjen e ankesës,

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, me datë 20.04.2018, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore, ku palët rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të përmendura më sipër.

Gjatë seancës dëgjimore rezultoi nga deklaratimet e ankuesit Z. , se ky i fundit është palë në një proces gjyqësor, objekti i të cilit lidhet pikërisht me informacionin që përbën dhe objektin e kërkesës dhe ankesës së tij.

Përfaqësuesja e Autoritetit Publik në seancë sqaroi se: “Informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion pasi nuk përbën informacion publik duke qenë se bëhet fjalë për një vendim për të cilin kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin për ta disponuar”.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me dokumentin e kërkuar, objekt shqyrtimi gjen zbatim ligji 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Në nenin 8 të tij parashikohet se, kompensimi i pronës bëhet nga fonde fizike ose financiare shtetërore, pra publike, çka nënkupton interes të publikut në njohjen me këto akte. Në përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik i bëhet referim nenit 64 të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i cili përcakton se: “Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve të pronës, përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe institucioneve shtetërore, që kanë kompetenca vendimmarrëse të njohura me ligj për trashëgiminë e pronave.”

Vlen të theksohet se objekti i kërkesës është kopje e vendimit të Autoritetit Publik si një akt publik dhe jo si dokument pronësie sikurse parashikon në parim kjo dispozitë.

Komisioneri vlerëson se neni në fjalë nuk i referohet akteve publike të prodhuara nga autoritetet publike, njohja me të cilat rregullohet nga dispozitat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por atyre dokumenteve të cilave iu ka mbaruar afati i shërbimit operativ pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese dhe që i kanë kaluar arkivit shtetëror. Gjithashtu ky nen është i zbatueshëm edhe për dokumentet e pronësisë me karakter personal që i kanë kaluar për ruajtje dhe administrim arkivit shtetëror dhe që i nevojiten një individ (trashëgimtarit) ose një institucioni shtetëror me kompetenca vendimmarrëse (siç mund të jetë ATP-ja ose gjykata) në procesin e zgjidhjes dhe vendimmarrjes lidhur me çështje me karakter trashëgimor/pronësor.

Bazuar në pikën 5 të nenit 27, të po këtij ligji, Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të përgjegjësisë të ngarkuara me ligj, shprehet me vendim. Vendimet e dhëna duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkruara nga titullari dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu duke pasur parasysh edhe cilësimin që i është bërë vendimeve të ATP-së nga Gjykata Kushtetuese (Vendimet nr. 27 datë 26.05.2010 dhe Vendimi nr. 1 datë 16.01.2017) dhe Gjykata e Lartë (Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara nr. 4 datë 10.12.2013, Vendimi i Kolegjit Civil nr. 3310 datë 19.12.2016) të cilat i kanë konsideruar vendimet ATP-së si vendime “quasi” gjyqësore të gjykimit në shkallë të parë, këto

dokumente përmbushin kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”, dhe konsiderohen informacion publik. Për analogji, këto vendime duhet të bëhen publike me kufizimet që zbatohen për vendimet gjyqësore përsa i përket anonimizimit të të dhënave personale.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Z. kundër Autoritetit Publik “Agjencisë së Trajtimit të Pronave”, Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative, dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 10 Prot., datë 04.01.2018 të Z. kundër Autoritetit Publik “Agjencisë së Trajtimit të Pronave”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit sipas objektit të kërkesës për informacion dhe më konkretisht: *Kopje të Vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. 155 datë 04.07.1995 - brenda datës 17. 5 .2018.*
3. Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 09. 5 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

